



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 08.05.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.05.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **“Preventiva vet” shpk; “Diagnoza vet” shpk; NTSH “Mala Farm”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Vaksionimi i gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve shtëpiak”**, me Nr. të Prok: **616-18-1598-2-2-1** nxjerr:

V E N D I M

1. *Refuzohet* kërkesa për ri-shqyrtim e grupit të Operatoreve Ekonomik të **“Preventiva vet” shpk; “Diagnoza vet” shpk; NTSH “Mala Farm”** të dt. 07.05.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Vaksionimi i gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve shtëpiak”** me Nr. **616-18-1598-2-2-1** Nr. Brendshëm **616-18-042-2-2-1**, kundër *Njoftimit për eliminim* të AK –së, të datës 03.05.2018 .
2. *Vërtetohet* vendimi i AK për *dhënje të kontrates* me datë: 02.05.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin “Vaksionimi i gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve shtëpiak”* me Nr. **616-18-1598-2-2-1** Nr. Brendshëm **616-18-042-2-2-1**.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i Operatoreve Ekonomik: **“Preventiva vet” shpk; “Diagnoza vet” shpk; NTSH “Mala Farm”** me datë 07.05.2018, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Vaksionimi i gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve shtëpiak”**, me Nr. të Prok: **616-18-1598-2-2-1**; me Nr. të brendshëm të prokurimit: **616-18-042-2-2-1**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 08.05.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi se: pika 39.5 AK mund te ftoj OE per te plotesuar apo per te qartuesuar certifikatat apo dokumentat e paraqitura ne pajtim me nenet 65-71 te LPP eshte i paqendrueshem bazuar ne faktet e paraqitura ne vijim:

1. Nuk keni dorezuar listen e projekteve te realizuara ne tre vitet e fundit.
2. **Sipas paragrafit 4 të nenit 59 të këtij ligji, AK-ja do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.**
Nëse gjatë një aktiviteti të prokurimit, një Autoritet Kontraktues në dosje të tenderit ka vendos kërkesën që Operatori Ekonomik të këtij kontrata të realizuara në tri vitet e fundit, 2015, 2016 dhe 2017, kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK duhet të jenë të realizuar pra të përfunduara brenda viteve të cekura. Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës.
 - Kështu kontrata me nr. te prokurimit: 40800/16/004215 që ju pretendoni se keni referencë është kontratë e pa përfunduar andaj edhe kontratat e papërfunduara nuk mund te llogariten si kontrata te përfunduara
 - Kontrata me nr. te prokurimit: 612 17 103 236 ne vlere 9.790,⁰⁰ euro
 - Kontrata me nr. te prokurimit: 612 16 042 221 ne vlere 9.975,⁰⁰ euro
 - Kontrata me nr. te prokurimit: 612 15 026 236 ne vlere 9.910,⁰⁰ euro

Gjithsej vlere e kontratave te përfunduara dhe te dëshmuara me referenca është 29.675,⁰⁰ euro.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit